



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr.226 , datë 02.06.2021

PËR

VERIFIKIMIN E PLOTËSIMIT NGA KANDIDATJA ZNJ. {...} TË TRE KRITEREVE TË KANDIDIMIT PËR NGRITJEN NË DETYRË NË GJYKATËN E APELIT DURRËS PËR POZICIONIN E LIRË NË FUSHËN E TË DREJTËS PENALE, TË SHPALLUR ME VENDIMIN NR. 129, DATË 01.04.2021, TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR DHE VIJIMIN E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT PËR KRITERET E TJERA LIGJORE TË KANDIDIMIT

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 02.06.2021, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e tre prej kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Apelit Durrës, të kandidatës znj. {...}”, përgatitur nga relatori z. Alban Toro, si dhe pasi shqyrtoi propozimin për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatës së Apelit Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 129, datë 01.04.2021, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale,

VËREN

I. PROCEDURA E VERIFIKIMIT

1. Me Vendimin nr. 129 datë 01.04.2021, Këshilli i Lartë Gjyqësor (më poshtë referuar si Këshilli) ka vendosur:

“1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Durrës, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale...”

2. Njoftimi për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë për këtë pozicion të lirë është publikuar në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, më datë 01.04.2021, duke përfunduar kështu afati i kandidimit më datë 16.04.2021.

3. Brenda afatit të kandidimit për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale të shpallur me Vendimin nr. 129, datë 01.04.2021 ka kandiduar edhe znj. {...} (më poshtë referuar si kandidatja), aktualisht e komanduar në detyrën e nëpunësit përgjegjës në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

4. Me Vendimin nr. 180, datë 29.04.2021, "Për fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatat e Apelit Durrës, Korçë dhe Vlorë, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet nr. 129, nr. 132 dhe nr.135, datë 01.04.2021", Këshilli ka vendosur:

"1. "Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatat e Apelit Durrës, Korçë dhe Vlorë, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet nr. 129, nr. 132 dhe nr.135, datë 01.04.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor."

2. Caktimin e relatorit për secilin kandidat, si më poshtë: ...4.Për kandidaten znj. {...}-relator z. Alban Toro; ...".

5. Më datë 29.04.2021, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Seksionin A, Kreu VI, të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor 75/2019 "Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë", në rrugë elektronike, kandidatja u njoftua: - për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit; - për caktimin e relatorit të kësaj procedure verifikimi; - për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit të caktuar dhe/ose të çdo anëtar tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi.

6. Brenda afatit të përcaktuar kandidatja nuk parashtrroi ndonjë pretendim në lidhje me relatorin e caktuar për procedurën e verifikimit ndaj saj apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

7. Në lidhje me verifikimin e pasurisë dhe të figurës së kandidatit, në kuadër të ngritjes në detyrë, në kushtet kur kandidatja është subjekt rivlerësimi "ex officio" sipas Ligjit nr. 84/2016 "Për procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", proces ky që për kandidaten nuk ka përfunduar, referuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në Ligjin nr.84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", si dhe në pikën 2¹, Seksioni B, Kreu X, të Vendimit 75/2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor, me Shkresën nr. 1993 prot., 06.05.2021, i ka kërkuar

¹ "Kandidatët që i nënshtrohen procedurës së rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr.84/2016 dhe janë në procedurë e sipër rivlerësimi ose për të cilët kjo procedurë nuk ka filluar ende, nuk i nënshtrohen procedurës së verifikimit të pasurisë dhe të figurës nga Këshilli, sipas përcaktimeve të pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të Ligjit për Statusin. Vendimi i Këshillit për kualifikimin ose jo për këta kandidatë do të mbështetet në vendimin e dhënë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit. Në këtë rast, Këshilli i kërkon Komisionit të Pavarur të Kualifikimit trajtimin me përparësi të procedurës së rivlerësimit për këta kandidatë. Nëse Komisioni i Pavarur i Kualifikimit nuk i përgjigjet kërkesës së Këshillit ose nuk përfundon procedurat e rivlerësimit për këta kandidatë brenda 3 muajve nga momenti i paraqitjes së kërkesës, këta kandidatë i nënshtrohen procedurës së verifikimit të pasurisë dhe të figurës sipas përcaktimeve të pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të Ligjit për Statusin"

Komisionit të Pavarur të Kualifikimit trajtimin me përparësi të procedurës së rivlerësimit kalimtar ndaj kandidatës.

8. Më datë 30.04.2021, bazuar në pikën 8, seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, në rrugë elektronike, kandidatës iu dërguan formularët dhe autorizimet përkatëse (të përcaktuara në pikën 6, seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019) që duhet të plotësoheshin dhe dorëzoheshin prej saj në kuadër të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit.

9. Brenda afatit pesëditor, kandidatja depozitoi rregullisht dokumentacionin e kërkuar të kandidimit, pranë Zyrës së Protokollit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, ndërsa një nga dokumentet, pikërisht formularin e deklaratës së pasurisë, sipas Vendimit 75/2019, kandidatja duhet ta dorëzojë, jo më vonë se 21 ditë nga dita e dërgimit të tij, pra deri më datë 21.05.2021, pranë ILDKPKI-së.

10. Në vijim të procedurës së verifikimit, më datë 06.05.2021, bazuar në pikën 10, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, përmes shkresave të veçanta, u kërkuar informacion dhe raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, për kandidatët e gjykatave të apelit, ndër ta edhe për kandidaten znj. {...}. Për këto kriterë ligjore kandidimi procedurat e verifikimit janë në proces e sipër.

11. Sipas pikës 9, të Vendimit të Këshillit nr.129, datë 01.04.2021, është përcaktuar se: *“Për kandidatin, për të cilin me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor verifikohet plotësimi i kriterëve ligjore të kandidimit sipas shkronjave “a”, “c” dhe “ç”, të pikës 5, të këtij vendimi, fillon menjëherë procesi i vlerësimit etik dhe profesional: ...”*. Ndërkohë, në pikën 5, shkronja “a”, të Vendimit të Këshillit nr.129, datë 01.04.2021, përcaktohet se: *“Kriteret ligjore që duhet të plotësojë kandidati për t’u ngritur në detyrë pranë gjykatës së shkallës së dytë përcaktohen..., si më poshtë: a) Kandidati duhet të ketë ushtruar funksionin jo më pak se shtatë vjet në shkallën e parë, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës penale, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar”*. Nga ana tjetër, në shkronjat “c” dhe “ç”, të pikës 5, të këtij vendimi, përcaktohet se: *“c) Kandidati duhet të mos ketë masë disiplinore në fuqi; ç) Kandidati duhet të mos jetë në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”*.

12. Në respektim të vendimit si më lart të Këshillit, sa i përket plotësimit të tre kriterëve formale të sipërpërmendura të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës, me qëllim realizimin paralelisht edhe të procedurave të vlerësimit etik dhe profesional të kandidatëve, pra në funksion të përmbylljes sa më parë të procedurave të kandidimit, për kandidaten znj. {...} u kërkuar dhe u administruar informacioni i nevojshëm nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, si organi kompetent për krijimin dhe administrimin e dosjeve personale dhe regjistrin të gjyqtarëve, si dhe nga gjykatat ku kandidatja ka ushtruar funksionin e gjyqtarës.

12.1 Për verifikimin e kriterëve të “përvojës profesionale minimale” dhe atij të “mospasjes masë disiplinore në fuqi”, Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, me Shkresën nr.1872/1 prot., datë 05.05.2021, përcolli informacionin dhe dokumentacionin përkatës të administruar për kandidaten znj. {...}, siç do të përshkruhet më poshtë.

12.2 Sa i përket kriterit të “përvojës profesionale minimale” dhe pikërisht sa i përket “përvojës specifike profesionale” të kandidates në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë ku ajo ka kandiduar, pra në fushën e të drejtës penale, referuar gjykatave ku kandidatja ka ushtruar funksionin e gjyqtarës, konkretisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër, u administrua informacioni i ardhur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër në kuadër të procesit të verifikimit të kushteve të kandidimit të znj. {...} për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës. Konkretisht, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër informacioni është përcjell me Shkresën nr. 203/2 prot., datë 07.05.2021, siç do të përshkruhet më poshtë.

II. REZULTATET E VERIFIKIMIT PARAPRAK PËR TRE KRITERET E KANDIDIMIT

13. Për kandidaten znj. {...} u verifikua kriteri i “përvojës profesionale minimale”.

14. “Përvoja profesionale minimale” për ngritjen në detyrë në gjykatën e shkallës së dytë në rastin konkret në Gjykatën e Apelit Durrës, që gjen reflektim në shkronjën “a”, të pikës 5, të Vendimit të Këshillit nr.129, datë 01.04.2021, është parashikuar si kusht kandidimi në nenin 47, pika 4, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: *“Magjistrati mund të ngrihet në detyrë në pozicione pranë gjykatave ose prokurorive të shkallës së dytë, nëse ka ushtruar funksionin jo më pak se shtatë vjet në shkallën e parë, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar”.*

15. Për verifikimin e kandidates në lidhje me plotësimin e këtij kriteri për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës u mbajt parasysh se ajo ka kandiduar për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, çka do të thotë se kandidatja, krahas përvojës së përgjithshme profesionale minimale, që është jo më pak se shtatë vjet, duhet të plotësojë edhe përvojën specifike profesionale minimale, pra jo më pak se pesë vjet në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë, konkretisht në fushën e të drejtës penale për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 129, datë 01.04.2021.

16. Në lidhje me përvojën e përgjithshme profesionale, në kërkesat për shprehje interesi dhe në jetëshkrimin e dorëzuar nga kandidatja, evidentohet se ajo ka përfunduar Fakultetin e Drejtësisë në vitin 1988, ndërkohë që është emëruar si gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, për periudhën 1994-2003. Më pas ajo është emëruar si inspektore në Drejtorin e Inspektimit të Gjyqësorit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Çështjeve të drejtësisë në Ministrinë e Drejtësisë

ku ka ushtruar funksionin e inspektorit për periudhën 2003-2010. Nga shtatori 2010 është emëruar në funksionin e Inspektore pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë deri në shtator 2015 ku ka përfunduar mandati 5 vjeçar. Në maj 2016 ajo është riemëruar inspektore me marrjen e një mandati të dytë. Në periudhën dhjetor 2019 i është deklaruar statusi i Magjistratit dhe vijimi i komandimit në detyrën e nëpunësit përgjegjës në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

17. Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjell nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, kandidatja znj. {...}, fillimin në detyrë e ka sipas Vendimit nr. 5 datë 01.07.1994 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, nëpërmjet të cilit emërohet gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër. Më pas, me Vendimin nr.137/7 datë 19.03.2003 të KLD-së lirohet nga detyra e gjyqtares me kërkesën e saj. Në vazhdim znj.{...} është emëruar inspektore në Drejtorinë e Inspektimit të Gjyqësorit, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Çështjeve të Drejtësisë në Ministrinë e Drejtësisë menjëherë pas liritimit me dorëheqje nga detyra e gjyqtares, detyrë të cilën e ka mbajtur deri me datë 15.09.2010, kur me vendimin nr. 268 datë 15.09.2010 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë ajo është emëruar Inspektore në Inspektoratin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Në vijim, me Vendimin nr.65 datë 27.05.2016 është konstatuar mbarimi i mandatit të inspektore dhe riemërimi në detyrën e inspektore për një mandat të dytë. Më vendimin nr.313 datë 19.12.2019 ² të Këshillit të Lartë Gjyqësor është

² Referuar vendimit nr. 313, datë 19.12.2019, “Për deklarimin e statusit të magjistratit për znj. {...}” është arsyetuar se: “...omissis... Duke qenë se, inspektorja {...} ka kaluar menjëherë nga detyra e gjyqtares në atë të inspektore ne Ministrinë e Drejtësisë, ku gëzonte statusin e gjyqtarit dhe më pas në detyrën Inspektore në ish-KLD, në zbatim të nenit 28, pika 4, të ligjit nr. 9877, datë 18.02.2008, “Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor”, i ndryshuar me ligjin nr. 114/2013, datë 11.04.2013, ajo ka gëzuar statusin e gjyqtarit për efekt të vjetërsisë në punë dhe pagës./Fakti që ajo ka filluar të punojë në këto detyra pa komandim nga ish Këshilli i Lartë i Drejtësisë, (sepse emërimi i saj është bërë para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 9877, datë 18.02.2008, “Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor”, i ndryshuar me ligjin nr. 114/2013), njëkohësisht nuk i humbet asaj të drejtën sipas pikës 4 të nenit 28, të ligjit të cituar më sipër, që ajo të mos e gëzojë këtë status. Për më shumë vërtetohet se ajo ka bërë brenda afateve ligjore 3 (tre) kërkesa për emërimin e saj si gjyqtare në pozicionet e shpallura të lira, por ato nuk janë pranuar nga ish Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe nuk është përgjegjësia e saj që ajo nuk është kthyer te punoj në detyrën e gjyqtares brenda afateve ligjore të përcaktuara nga ligja për komandimin në institucionet e tjera të drejtësisë..../Fitimi i statusit të nëpunësit civil gjatë kohës që ajo ka punuar në Ministrinë e Drejtësisë nuk nënkupton humbjen automatike të statusit të gjyqtarit sepse statusi i nëpunësit civil është fituar për shkak të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” nga të gjithë të punësuarit në pozicione pune të shërbimit civil në administratën shtetërore, në institucionet e pavarura apo njësi të qeverisjes vendore.”..... Për sa më sipër, Këshilli i Lartë Gjyqësor arrin në përfundimin se, inspektorja {...} e ka ruajtur statusin e gjyqtarit, prandaj asaj duhet ti konfirmohet statusi i magjistratit, duke vijuar komandimin në detyrën e nëpunësit përgjegjës në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor deri krijimin e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë...omissis...”

deklaruar pasja e statusit të magjistratit dhe është komanduar në detyrën e nëpunësit përgjegjës në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor ku dhe vijon aktualisht.

18. Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, Këshilli vlerëson se kandidatja znj. {...}, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës, për pozicionin e lirë (në fushën e të drejtës penale) të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 129, datë 01.04.2021, ka mbi shtatë vjet përvojë të përgjithshme profesionale si gjyqtare e gjykatës së shkallës së parë dhe si gjyqtare e komanduar, duke plotësuar kështu kriterin “përvojës profesionale minimale”.

19. Në lidhje me përvojën specifike profesionale, në kërkesën për shprehje interesi, kandidatja ka deklaruar se ka ushtruar detyrën e gjyqtares në seksionin penal dhe pak në seksionin civil pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, për një periudhë nëntë vjeçare.

20. Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjell nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër, rezulton se:

Nga verifikimi i në regjistrat penal të çështjeve gjyqësore për periudhën nga data 01.07.1994 deri në datën 19.03.2003, periudhë në të cilën znj. {...}, ka ushtruar detyrën e gjyqtares pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër. Nga verifikimi rezultoi se çështjet penale të gjykuara nga gjyqtarja {...}, në cilësinë e kryesueses apo të anëtares së trupit gjykues, vijon si më poshtë:

-Për vitin 1994 ka gjykuar 14 çështje; për vitin 1995 ka gjykuar 54 çështje; për vitin 1996 ka gjykuar 125 çështje; për vitin 1997 ka gjykuar 56 çështje; për vitin 1998 ka gjykuar 110 çështje; për vitin 1999 ka gjykuar 38 çështje; për vitin 2000 ka gjykuar 70 çështje; për vitin 2001 ka gjykuar 58 çështje; për vitin 2002 ka gjykuar 57 çështje; për periudhën janar – mars 2003 ka gjykuar 5 çështje.

21. Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjell nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, për kandidaten znj. {...} rezulton se;

- Me Vendimin nr. 268 datë 15.09.2010 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë ajo është emëruar inspektore në Inspektoratin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Më pas me vendimin nr.65 datë 27.05.2016 është konstatuar mbarimi i mandatit të inspektores dhe riemërimi në detyrën e inspektores për një mandat të dytë.

21.1 Përvoja profesionale e kandidatës si inspektore pranë Inspektoriatit të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, për efekt të përvojës specifike profesionale është eksperiencë në fushën e të drejtës penale. Pavarësisht se në asnjë dispozitë ligjore kjo gjë nuk thuhet në mënyrë eksplicite kjo

konkludohet nga natyra e punës që ka kryer kandidatja në pozicionin e inspektorit si dhe nga interpretimi i një sërë dispozitash ligjore. Referuar nenit 1 të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoriatit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë”³, objekt i veprimtarisë së Inspektoriatit ishte: “*a. Mbledhja e të dhënave rreth veprimtarisë së gjykatave dhe gjyqtarëve, nëpërmjet verifikimit të ankesave, inspektimit të gjykatave, inspektimit të gjyqtarëve dhe vlerësimit të aftësive të tyre profesionale, mbi të cilat Këshilli i Lartë i Drejtësisë zhvillon përgjegjësitë ligjore të tij. b. Konstatimi i ekzistencës së shkeljeve disiplinore apo të rasteve të shkarkimit të gjyqtarëve dhe dokumentimi i tyre, nëpërmjet verifikimeve dhe inspektimeve, mbi të cilat nga autoriteti përgjegjës mund të fillohet procedimi disiplinor i gjyqtarëve ...*”.

Me ndryshimet kushtetuese të vitit 2016, në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, u parashikua një organ i ri kushtetues, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, i cili referuar pikave 1 dhe 2, të nenit 147/d) të Kushtetutës është përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin me nismë të shkeljeve dhe fillimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, sipas procedurës së përcaktuar me ligj. Inspektori i Lartë i Drejtësisë është përgjegjës edhe për inspektimin institucional të gjykatave dhe të zyrave të prokurorisë.

21.2 Ndërkohë, sipas pikës 2, të nenit 47 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përcaktohet se: “*a) për pozicionin gjyqtar në gjykatën e posaçme të shkallës së parë për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimin të organizuar, magjistrati duhet të ketë ushtruar funksionin jo më pak se shtatë vjet si gjyqtar, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar në fushën e drejtësisë kriminale ose si inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar; b) për pozicionin gjyqtar apeli në Gjykatën e Posaçme të Apelit për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimin të organizuar, magjistrati duhet të ketë ushtruar funksionin jo më pak se dhjetë vjet si gjyqtar, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar për çështjet penale ose si inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë; ...”.* Nga interpretimi sistematik i dispozitave të tjera ligjore, aktualisht puna si inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë konsiderohet përvojë specifike profesionale në fushën e të drejtës penale. Për rrjedhojë, edhe puna e kandidatës si inspektore pranë Inspektoriatit të ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ku fusha e veprimtarisë është pothuaj e njëjtë me atë që ka sot Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë konsiderohet si përvojë specifike profesionale, pikërisht në fushën e të drejtës penale.

22. Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, Këshilli vlerëson se kandidatja znj. {...},, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës, për pozicionin e lirë (në fushën e të drejtës penale) të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 129, datë 01.04.2021, ka mbi pesë vjet përvojë

³ Miratuar me vendimin nr. 195/2/a, datë 05.07.2006, Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoriatit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, shtuar dhe ndryshuar me Vendimin nr.207/1, datë 07.02.2007, si dhe Vendimin nr.55 datë 28.05.2014, të KLD.

profesionale në fushën e të drejtës penale, duke plotësuar kështu kriterin e “përvojës specifike profesionale minimale”.

23. Për kandidaten znj. {...} u verifikua edhe kriteri i “mospasjes masë disiplinore në fuqi”.

24. “Mospasja masë disiplinore në fuqi” si kriter për ngritjen në detyrë edhe në gjykatën e shkallës së dytë, që gjen reflektim në shkronjën “c”, të pikës 5, të Vendimit të Këshillit nr. 129, datë 01.04.2021, është parashikuar në nenin 48, pika 8, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: *“Vetëm kandidatët të cilët ... nuk kanë masa disiplinore në fuqi, pranohen në procedurat e mëtejshme të ngritjes në detyrë”.*

25. Në lidhje me këtë kriter, në rastin e aplikimit, kandidatja ka depozituar formularin e Vetëdeklarimit “Për masa disiplinore” datë 15.04.2021, nëpërmjet të cilës, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se: *“Nuk kam masë disiplinore në fuqi”.*

26. Sipas informacionit të përcjell nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, kandidatja znj. {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

27. Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, Këshilli vlerëson se nuk vërtetohet që kandidatja znj. {...} të ketë masë disiplinore në fuqi, duke plotësuar kështu kriterin e “mospasjes masë disiplinore në fuqi”.

28. Për kandidaten znj. {...} u verifikua edhe kriteri i “papajtueshmërisë ambientale”.

29. Papajtueshmëria ambientale si kriter ndalues për ngritjen në detyrë edhe në gjykatën e shkallës së dytë, që gjen reflektim në shkronjën “ç”, të pikës 5, të Vendimit të Këshillit nr. 129, datë 01.04.2021, është parashikuar në nenin 8, pika 2, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: *“Këshillat, gjatë ... ngritjes në detyrë të magjistratit, për aq sa është e mundur dhe pa cenuar në mënyrë joproporcionale të drejtën për zhvillimin normal të karrierës profesionale të magjistratit, marrin masa për të shmangur papajtueshmërinë ambientale, sipas pikës 3, të këtij neni, me qëllim që të garantohet besimi i publikut në sistemin e drejtësisë, pavarësia dhe paanësia e magjistratit, eficienta e gjykatave dhe zyrave të prokurorisë në dhënien e drejtësisë”.* Ndërkohë, kuptimi i papajtueshmërisë ambientale përcaktohet në pikën 1, të kësaj dispozite ligjore, sipas të cilës: *“Papajtueshmëria ambientale, në kuptimin e këtij neni, krijohet për shkak të lidhjeve të ngushta familjare mes magjistratëve, që janë përkatësisht bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, ose të afërmit e tij deri në shkallë të dytë”.* Sa i takon rasteve të papajtueshmërisë ambientale për sa lidhet me ngritjen në detyrë në gjykatën e shkallës së dytë, ato parashikohen në pikën 3, shkronja “a”, të kësaj dispozite ligjore, ku përcaktohet se: *“Papajtueshmëria ambientale përbëjnë rrethanat e mëposhtme: a) nëse respektivisht në të njëjtën gjykatë ose prokurori ku magjistrati kërkon të caktohet, ushtron funksionin një magjistrat tjetër, që ndodhet në kushtet e pikës 1 të këtij neni”.*

30. Në lidhje me papajtueshmërinë ambientale, në rastin e aplikimit, në përputhje me detyrimin sipas nenit 8, pika 5, të Ligjit për Statusin, kandidatja ka depozituar formularin e Vetëdeklarimit “Për situatën e papajtueshmërisë ambientale” datë 15.04.2021, nëpërmjet të cilës, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se: *“Nuk do të ndodhem në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”*.

31. Gjatë verifikimit nuk rezultoi ndonjë e dhënë e ndryshme nga ajo e deklaruar nga kandidatja në lidhje me situatën e papajtueshmërisë ambientale për sa ajo kandidon për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës.

32. Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, Këshilli vlerëson se për kandidaten znj. {...} nuk vërtetohet të ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale në rast të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës, duke plotësuar kështu kriterin e “papajtueshmërisë ambientale”.

III. KONKLUZIONE

33. Referuar kërkesave të Vendimit 75/2019, duke mbajtur parasysh edhe përcaktimet e Vendimit nr. 129, datë 01.04.2021, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar gjatë procedurës së verifikimit paraprak të tre kriterëve formale të kandidimit të znj. {...}, për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se procedura e verifikimit e ndjekur në këtë rast është e plotë dhe në përputhje me ligjin.

34. Bazuar në sa më lart është parashtruar mbi rezultatet e verifikimit paraprak të tre kriterëve formale të kandidimit për kandidaten znj. {...}, konkretisht të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se kandidatja i plotëson ato, ndërsa nuk ekziston ndonjë shkak për skualifikimin e saj nga kandidimi në lidhje me këto kriterë. Nisur nga kjo, Këshilli çmon se është vendi për verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës, të tre kriterëve të sipërpërmendura të kandidimit dhe vijim e procedurës së verifikimit të kandidatës për kriteret e tjera ligjore, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin nr. 129, datë 01.04.2021.

PËR KËTO ARSYE

Mbështetur në pikën 3, të nenit 136, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 8, në pikën 5, të nenit 47, në pikën 8, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimin e tij nr. 75, datë 23.05.2019

“Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, si dhe në pikën 9, të Vendimit të tij nr. 129, datë 01.04.2021, “Për hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Durrës, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale”, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

VENDOSI:

1. Verifikimin e plotësimit nga kandidatja znj. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin nr. 129, datë 01.04.2021, të kritereve të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.
2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatës së Apelit Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin nr. 129, datë 01.04.2021.
3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqjen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR